



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:220414  
Datë: 21.03.2024  
Numri i dokumentit: 05487130

CA.nr.1861/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Bujar Muzaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të propozueses së sigurimit K.Sh. nga Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson U.B., avokat në Ferizaj, kundër kundërshtarit të sigurimit, V.H. nga Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.Q., avokat në Ferizaj, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsisë, duke vendosur sipas ankesës së propozueses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.169/22, të datës 22.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e propozueses së sigurimit K.SH. nga Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.169/22, i datës 22.12.2023, në pikën I të dispozitivit VËRTETOHET.

Pika II e dispozitivit të aktvendimit mbetet e pashqyrtuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan me aktvendimin e atakuar CN.nr.169/22, të datës 22.12.2023 në pikën I të dispozitivit ka konsideruar të tërhequr propozimin e propozueses së sigurimit K. Sh. nga Ferizaj të ushtruar kundër kundërshtarit të sigurimit V.H. nga Ferizaj, me të cilin propozuesja ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit detyrohet propozuesja e sigurimit që kundërshtarit të sigurimit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 410.50€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, nën pasojat ligjore të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi propozuesja , në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që ankesa të aprovohet, ndërsa aktvendimi i atakuar të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në procedim të sërishëm.

Me përgjigje në ankesë kundërshtari i sigurimit i ka kontestuar në tërësi pretendimet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e propozueses dhe ta vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e propozueses së sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesja K.Sh., nga Ferizaj, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 16.08.2022, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, me të cilën ka kërkuar që kundërpropozuesit V.H., t'i ndalohej që të shfrytëzoj ngastrën kadastrale me nr....., të futet në çfarëdo forme në ngastrën në fjalë apo të posedoj ngastrën kadastrale me nr. .... më gjerësisht si në propozim.

Gjykata Themelore në Ferizaj, fillimisht me aktvendimin C.nr. 2022/166564 të datës 17.08.2023, e aprovoi si të bazuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndërsa pas vlerësimit pretendimeve të kundërshtarit të sigurimit, gjykata gjeti se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit dhe vendosi ta anuloj aktvendimin e datës 17.08.2022, ndërsa propozimin ta refuzoj si të pabazuar. Sipas ankesës së propozueses Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr. 8678/22, dt. 18.09.2023, e anuloi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e kthyer lëndën në procedim të sërishëm, me arsyet dhe sugjerimet si në aktvendimin në fjalë.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën dëgjimore, duke e ftuar propozuesen në adresën e dhënë si në shkresat e lëndës, e që nga flet kthesa konstatohet se propozuesja është e panjohur në atë adresë. Përveç propozueses gjykata i ka dërguar ftesa edhe përfaqësuesve të autorizuar, të cilët siç rezulton nga provat shkresore, në faza të ndryshme të procedurës kanë pasur autorizime për përfaqësim të propozueses, përkatësisht nuk kishte dëshmi për revokim të

autorizimit. Kështu, nga provat në shkresat e lëndës konstatohet se ftesa i është dërguar avokatit P.Ll. dhe avokatit U.B.

Siç duket gjykata kishte bërë përpjekje shtesë që ftesa t'i dërgohet edhe avokates Y.D., e cila megjithëqë nuk kishte paraqitur ndonjë autorizim për përfaqësim të propozueses, me datën 02.11.2023 i ishte drejtuar gjykatës me kërkesë për sigurimin e shkresave të lëndës, duke pohuar se është e autorizuar në tri raste gjyqësore për përfaqësimin e klientes K.Sh.

Meqenëse në seancën gjyqësore për propozuesen e sigurimit nuk ka prezantuar askush, gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që propozimi për masën e sigurimit të kërkesëpadsisë të konsiderohet i tërhequr, për çka me referim në dispozitën e nenit 409 të LPK-së edhe vendosi si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të cilat i ka pretenduar pala paditëse me ankesë.

Deri në një përfundim të tillë, Gjykata e Apelit arriti pasi nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti që propozuesja gjykatën nuk e kishte njoftuar për ndërrimin e adresës duke pamundësuar kështu komunikimin e drejtpërdrejt të gjykatës me propozuesen, ndërsa thirrjes për seancë nuk i është përgjigjur i autorizuari i propozueses, avokati P.Ll. (sipas autorizimit të dhënë me datë 03.11.2022) dhe as avokati U.B., i cili e kishte përfaqësuar paditësen në seancat e mëparshme lidhur me propozimin për masën e sigurimit. Meqenëse në rastin konkret, propozuesja përkatësisht të autorizuarit e saj nuk janë paraqitur në seancë prandaj Gjykata e Apelit vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet nga dispozitat e nenit 409 të LPK-së, që propozimi për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadsisë të konsiderohet i tërhequr, ashtu siç ka vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë si në aktvendimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se është përgjegjësi e palëve që të kujdesen në aspekt të përgjigjes ndaj thirrjeve të gjykatës, ta njoftojnë gjykatën për ndërrimin e adresës si dhe për përfaqësimin e tyre nga përfaqësues të autorizuar. Në të kundërtën, në prezencën e këtyre lëshimeve gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të LPK mund të ndërmarrë veprimet procedurale si në rastin konkret. Sidoqoftë tërheqja e propozimit në rastin konkret nuk ndikon negativisht në të drejtën e propozueses dhe as nuk paraqet pengesë që në të ardhmen, gjatë shqyrtimit të çështjes kryesore, eventualisht propozuesja të paraqet propozim të ri, nëse në të vërtetë vlerëson se ekzistojnë arsye bindëse, që para vendosjes meritore sipas padisë, të kërkoj sigurimin e kërkesëpadsisë, gjersa themelësinë e propozimit gjykata do të vlerësoj në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit të parashtruar.

Lidhur me këto arsye, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pa themeltë ankesën e propozueses duke e vërtetuar aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, duke shprehur bindjen se një vendim i tillë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Pika II e dispozitivit të aktvendimit lidhur me shpenzimet e procedurës ka mbetur e pashqyrtuar pasi propozuesja nuk ka paraqitur ankesë në këtë drejtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA.nr 1861/2024, me datë 11.03.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli